

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Lënda nr. P Nr. 8/2013**

**22 maj 2018**

---

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore e Mitrovicës, me Trupin Gjykses të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa në cilësinë Kryetares e Trupit Gjykses dhe gjyqtarët e EULEX-it Fransciska Fiser dhe Arnout Louter si anëtarë të trupit gjykses, me pjesëmarrjen e Dukagjin Kerveshit si zyrtar ligjo EULEX-it në cilësi të procesmbajtësit, në rastin penal kundër:**

**S. F., me nofkën 'S', shtetas i Republikës së Serbisë,;**

*I akuzuar me veprat penale si ne vijim: :*

1. Krim i organizuar, ndesh me nenin 274, paragrafin 3 të ish Kodit Penal të Kosovës ( tani e tutje "KPK"); lidhur me veprën penale të;
2. Blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të drogave të rrezikshme ndesh me nenin 229, paragrafin 4, nën-paragrafin 1 lidhur me paragrafin 2 të KPK-së;

Pas së seancave të shqyrtimit kryesorë, të hapura për publikun, mbajtur më 22 maj 2017, 4 korrik 2017, 25 shtator 2017, 17 tetor 2017, 18 dhjetor

2017, 26 shkurt 2018 dhe 23 mars 2018 në praninë e të akuzuarit (përveç më datën 25 shtator 2017), avokatit të tij mbrojtës dhe prokurorit të shtetit,

Pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues mbajtur më 23 mars 2018,

Mbështetur në nenin 366, paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës<sup>1</sup> (KPPK) më 26 mars 2018 gjatë seancës publike dhe në prani të të akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës dhe prokurorit të shtetit:

Shpall këtë:

## **AKTGJYKIM**

### **I akuzuari shpallet**

### **I PAFAJSHËM**

Sepse **nuk** është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm:

- Se gjatë muajit dhjetor 2010 i pandehuri së bashku me bashkëpunëtorët e tij A. T., R. D., J. P. dhe I. Z., duke punuar së bashku si anëtarë të një grupi të organizuar kriminal i stacionuar në K. dhe S. ishin përfshinë në aktivitet të paligjshëm të gjenerimit të drogave narkotike (heroin) në K. dhe duke e trafikuar drogën në B. të S. duke shfrytëzuar faktin se dy nga bashkëpunëtorët në rast, në kohën faktike, shërbenin si policë në policinë e S.
- Se gjatë asaj periudhe ka ekzistuar një ndarje e qartë e punëve dhe aktiviteteve të të pandehurit së bashku me bashkëpunëtorët e tij dhe ato

---

<sup>1</sup>Ligji Nr. 04/L-123 i Kodit të Procedurës ;

si në vijim: me të pandehurin S. F. si boshti kryesor bandës kriminale në Kosovë që ka pasur përgjegjësinë për kërkimin e heroinës në Kosovë duke përdorur rrjetin dhe kontaktet e tija; me A. T. si hallkë qenësore, si “ushtar” mes anëtarëve të bandës në K. dhe S., përgjegjës për të përcjellë informacionet nga anëtarët e bandës në S. te F. i cili ishte i stacionuar në Kosovë dhe anasjelltas; me J. P. dhe R. D., që të dy në atë kohë policë të S. të pozicionuar në L. dhe R. si përgjegjës për gjetjen e e blerësve të drogës në B. e gjithashtu edhe përgjegjës për kontrabandën e drogës në B.; si dhe me I. Z. si blerës i narkotikëve nga P. dhe T.

- Se në dhjetor të viti 2010, pas një varg kontaktimesh përmes telefonatave në mes T. dhe P., të dy u pajtuan të takohen në R. më 11 dhjetor 2010 prej nga së bashku shkuan në L. të takonin të pandehurin F. dhe arritën një marrëveshje lidhur me natyrën, çmimin dhe modalitetet e marrjes dhe dorëzimit të drogës te P. dhe D.
- se, pas këtij takimi, i pandehuri dhe bashkëpunëtorët e tij të supozuar u përfshinë në biseda telefonike tjera ku ata ranë dakord për të shkëmbyer drogë për para në dorë më 22 dhjetor 2010.

dhe as

- se më 22 dhjetor 2010 të personat e lartpërmendur u takuan në zonën C. R. për të shkëmbyer sasinë e 2 kg heroin ashtu si ishin marrë

Prandaj, në pajtim me Nenin 364 paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të KPP-së, i Pandehuri LIROHET nga akuzat për veprën penale Krimi i Organizuar ndesh me dispozitat e nenit 274 paragrafit 3 të Kodit Penal të Kosovës lidhur me veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm ndesh me dispozitat e nenit 229

paragrafin 3,4 dhe nën paragrafin 1 lidhur me paragrafin 2 të Kodit Penal të Kosovës.

## **Shpenzimet e procedurale**

Bazuar në nenin 450-454 të KPP-së shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit, kompensimi dhe shpenzimet e nevojshme të avokatit mbrojtës paguhen nga burimet buxhetore.

## **ARSYETIM**

### **A. Historiku procedural**

1. Aktvendimi mbi fillimin e hetimit kundër S. F. u lëshua nga Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë më 31 dhjetor 2010. Hetimi u zgjerua me aktvendimin e Prokurorisë Komunale në Mitrovicë lëshuar më 20 shtator 2011.
2. Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë ngritë Aktakuzën PP nr. 162/2010 të datës 20 dhjetor 2011 dhe e dorëzon atë në shkrimoren e Gjykatës Themelore të Mitrovicës më 22 dhjetor 2011, kundër të pandehurit S. F., i akuzuar për Krim të Organizuar, ndesh me nenin 274 paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës; lidhur me veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm, ndesh me Nenin 229 Paragrafi 4, nën-paragrafin 2 i KPK-së;
3. Duhet gjithashtu të theksohet se më 19 prill 2011, Prokuroria e Lartë Publike në B. ngrit Aktakuzën KT nr. 1219/10 kundër pesë pandehurve duke përfshirë S. F. për veprën penale të Prodhimit të Paligjshëm dhe

Trafikimit të Narkotikëve ndesh me nenin 246 paragrafi 3 i lexuar lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Serbisë.

4. Me Aktvendimin e Gjykatës së Lartë në Beograd Ki. 2591/10 urdhërohet paraburgimi kundër të pandehurit.
5. Me aktvendim e gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë PPS nr. 109/2010, i pandehuri S. F. ka qenë në paraburgim që nga 31 dhjetori 2010 deri më 27 shtator 2011. Më 27 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë zëvendësoi paraburgimin kundër S. F. me masën e paraburgimit shtëpiak, e cila i ishte ndërprerë më 11 janar 2012 – Aktvendimi PO. nr. 241/11.
6. Më 10 mars 2014, në pajtim me nenin 242, paragrafin 4 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale nr. 04 / L-123), Kryetari i Trupit Gjykses mbajti seancën fillestare të shqyrtimit kryesor lidhur me aktakuzën për këtë rast.
7. Me Aktvendimin e lëshuar më 13 tetor 2014, Kryetari i Trupit Gjykses hodhi poshtë si të pabazuara vërejtjet për pranueshmërinë e provave, si dhe kërkesën për hedhjen poshtë të aktakuzës, të dyja të dorëzuara më 3 prill 2014 nga avokati mbrojtës K. B. në emër të të pandehurit S. F..
8. Ky Aktvendim u miratua nga Gjykata e Apelit më 3 dhjetor 2014.

## **KOMPETENCA E GJYKATËS**

9. Sipas nenit 20 paragrafin 1 të KPPK-së, Gjykatat Themelore janë kompetente për të dëgjuar çështje penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon shqiptimin e dënimit penal prej së paku 5 vitesh. Në pajtim me nenin 29 paragrafin1)të KPPK-së, juridiksioni territorial është i

përshtatshëm me gjykatën në rrethin ku dyshohet se është kryer vepra penale.

10. Vepra penale në gjykim mundëson burgimin deri në 20 vjet dhe pretendohet se është kryer së paku pjesërisht në territorin e M..
11. Përveç kësaj, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, në pajtim me nenin 3.1 të Ligjit mbi Juridiksionin 03 / L-053, vendosi t'ia delegojë këtë rast Gjykatësve të EULEX-it për të ndjekur procedurën, duke pasur parasysh vendimin e datës 1 shtator 2010, të lëshuar nga Kryeprokurori i EULEX-it, që autorizon prokurorët e EULEX-it që kanë udhëhequr këtë rast të veprojnë si si prokurorë të PSRK-së.
12. Prandaj, Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës janë kompetent për të dëgjuar këtë çështje penale. Trupi Gjykues për këtë Shqyrtim Kryesor u caktua si më lartë.

## **B. SHQYRTIMI KRYESOR**

13. Duhet të theksohet se dy seancat e para u mbajtën në shqyrtimin e mëparshëm kryesor, respektivisht më 1 dhe 13 shtator 2016. Për shkak të ndryshimit në përbërjen e trupit gjykues, shqyrtimi kryesor aktual u rihap më 22 maj 2017.
14. Seancat e shqyrtimit kryesorë ishin të hapura për publikun dhe ato u mbajtën më 22 maj 2017, 4 korrik 2017, 25 shtator 2017, 17 tetor 2017, 18 dhjetor 2017, 26 shkurt 2018 dhe 23 mars 2018.
15. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të 22 majit 2017, i akuzuari u deklarua si i pafajshëm për të dy akuzat.

## **C. Procedura e provave**

### ***a) Provat e paraqitura gjatë rrjedhës së Shqyrtimit Kryesorë***

16. Gjatë seancës gjyqësore të 22 majit 2017, palët ranë dakord të konsideronin leximin e procesverbalit të datës 13 shtator 2016, që përmbante dëshmitë e dëshmitarëve M. T, A. K. dhe dëshmitarit ekspert nga forenzika S. D..
17. Në të njëjtën datë, 20 urdhra për përgjimet, të pranuar në dhjetor 2016 nga autoritetet serbe pas një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ligjore (BNJ) u konsideruan si pjesë e materialit provues.
18. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, më 4 korrik 2017 trupi gjykues e dëgjoji dëshmitarin R. D..
19. Më 26 shkurt 2017, prokurori citoi si prova dokumentet e renditura si në vijim:
20. Letra e përcjellëse e Policisë së Kosovës, e datës 31/12/2010, faqet 35-37;
21. Kallëzimi Penal kundër S. F., i datës 31/12/2010, faqet 38-44;
22. Raporti fillestar / incident, X, i datës 23/12/2010, faqet 45-48;
23. Shënim zyrtar – M. T. #, i datës 24/12/2010, faqet 49-51;
24. Raporti i Hetuesit - kapiten A. K. #, i datës 23/12/2010, faqet 52-54;
25. Raporti i Oficerit – I. F. #, , i datës 24/12/2010, faqet 55-56;
26. Vendimi për ndalimin policorë, i datës 30/12/2010, faqet 57-58;
27. Të drejtat e personit të arrestuar, i datës 30/12/2010, faqet 59-67;

## **Raportet e TFM-së:**

28. Analiza e dhënave të dhënave nga telefoni i konfiskuar, e datës 28/03/2011, faqet 68-85;
29. Pasqyrë e të dhënave telefonike të ekzaminuara, e datës 24/05/2011, faqet 86-95;
30. Analiza e numrit të telefonit celular X, e datës 27/05/2011, faqet 96-103;
31. Analiza e numrit të telefonit celular X-sms, e datës 27/05/2011, faqet 104-119;
32. Analiza e numrit të telefonit celular X- "Z.", e datës 30/05/2011, faqet 120-183;
33. Raporti i provave - Vështrim i përgjithshëm, i datës 13/06/2011, faqet 184-187;
34. Raporti informues, i datës 14/07/2011, faqet 188-193; deklaratat:
35. Procesverbal për marrjen në pyetje të të pandehurit, i datës 14/02/2011, faqet 284-295;
36. Deklarata e marrjes në pyetje të të pandehurit, e datës 16/02/2011, faqet 296-307;
37. Procesverbali i seancës dëgjimore në një hetim, i datës 29/07/2011, faqet 308-331;

Përmbajtja e dosjes së krim teknikës:



38. Krim teknika nr. 10-195, faqet 334-335;
39. Raporti për shqimin e vendit të ngjarjes - PK A. F. #, i datës 24/12/2010, faqet 336-341;
40. Lista e provave të krim teknikës - Zinxhiri i kujdestarisë, i datës 23/12/2010, faqet 342-346;
41. Lista e artikujve të sekuestruar, e datës 23/12/2010, faqet 347-348;
42. Foto A. - Nr., i datës 23/12/2010, faqet 349-376;
43. Raporti i Ekspertizës nga Laboratori Forenzikës - Sektori i Ekspertizës së Gjurmimit dhe Daktiloskopisë, i datës 10/02/2011, faqet 377-385;
44. Raporti i Ekspertizës Forenzike nga Njësia e Shkencave Juridike, Analizave Kimike, i datës 12/04/2011, faqet 386-391;
45. Raporti i ekzaminimit, i datës datë 18/05/2011, faqet 395-402;
46. Dokumentet e marra nga juridiksioni i huaj;
47. Kërkesa e DPP në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së S. për ndihmë të ndërsjellë juridike - lidhur me rastin PP # 162/10, e datës 08/07/2011, faqet 403-404;
48. Kërkesa e DPP-së në MRSK për dosjet penale të të pandehurit S. F., e datës 14/07/2011, faqet 405-406;
49. Letra përcjellëse e Zyrës Ndërlidhëse Rajonale të EULEX-it në DPP, e datës 27/08/2011, faqet 407-408;
50. Dosja Penale i S. F. nga Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë, e datë 01/09/2011, faqet 409-410;
51. Letra përcjellëse për DPP-në nga Zyrtari i EULEX-it për Bashkëpunim Rajonal - informacion shtesë, e datës 08/11/2011, faqet 411-412;

52. Dosja Penale nga Prokuroria Publike e Republikës së S., e datës 20/10/2011, faqet 413-416;
53. Letra përcjellëse për DPP-në nga Zyrtari i EULEX-it për Bashkëpunim Rajonal: raportet e bisedave të telefonisë mobile, e datës 27/09/2011, faqet 417-418;
54. Shënim zyrtar, B. S.- Zëvendësi i Autorizuar i Prokurorit të Përgjithshëm, datë 23/09/2011, faqet 419-420; Raportet mbi përmbajtjen e komunikimit.
16. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 07/12/2010, faqet 421-424;
17. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 08/12/2010, faqet 425-428;
18. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 10/12/2010, faqet 428-435;
19. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 11/12/2010, faqet 436-444;
20. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 12/12/2010, faqet 445-450;
21. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 13/12/2010, faqet 451-465;
22. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 14/12/2010, faqet 466-474;
23. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 15/12/2010, faqet 475-478;

24. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 16/12/2010, faqet 479-484;
25. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 16/12/2010, faqet 485-490;
26. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 17/12/2010, faqet 491-502;
27. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 19/12/2010, faqet 503-519;
28. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 21/12/2010, faqet 520-530;
29. Objekti: T. A. (T. 90U) – 062/9772-653, i datës 21/12/2010, faqet 531-536;
30. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 22/12/2010, faqet 537-550;
31. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 24/12/2010, faqet 551-561;
32. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 25/12/2010, faqet 562-568;
33. Objekti: J. P. (T. 94U) – 062/255-602, i datës 27/12/2010, faqet 468-581;
34. Në seancën e 26 shkurtit 2018, të pandehurit paraqitën deklaratat e tyre.

### ***b) Shkresat***

#### *Mocioni në lidhje me dëshmitarët R. D., A. T., J. P., N. D., I. Z., R. J. dhe B. S..*

35. Gjatë seancës gjyqësore të datës 22 maj 2017, mbrojtja kërkoi që përveç R. D.<sup>2</sup>, A. T., J. P., N. D., I. Z., R. J. dhe B. S..
36. Trupi Gjykes fillimisht e pranoi mocionin, por më vonë rishqyrtoi qëndrimin e tij dhe arriti në përfundimin se marrja në pyetje e këtyre dëshmitarëve është e paarritshme sipas nenit 258, paragrafi 2.3 të Kodit të Procedurës. Prandaj u vendos që këto dëshmi të mos administrohen.<sup>3</sup>

---

<sup>2</sup> Ky dëshmitar ishte dëgjuar më 4 korrik 2017

<sup>3</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor kryesor i 26 shkurtit 2018

### Njoftim për pohimin

37. Gjatë seancës gjyqësore të 26 shkurtit 2018, Prokuroria paraqiti një kërkesë për "njoftim për pohim", duke kërkuar që të paraqesë si dëshmi disa deklarata dhe dokumente të specifikuara aty.
38. Trupi e gjykues e hodhi poshtë kërkesën <sup>4</sup>.

### **Gjetjet faktike**

39. Më 22 dhjetor 2010, ndërsa në makinën e tij në zonën e C. R.- komuna e L., i pandehuri u qëllua, siç është vërtetuar edhe në raportin mjekësor të lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Torakale, Qendra Klinike Universitare e Kosovës, numri i protokollit. X i datës 30 Dhjetor 2010.
40. Rrethanat lidhur me të shtënat ndaj tij mbeten akoma nën hetime (numri i lëndës X).
41. Policia me të marrë informacionin se arsyeja për të shtënat ishte një marrëveshje për drogë që devijoi për të keq, ata më 23 dhjetor 2010 organizuan një operacion bastisjeje dhe kontrolli në shtëpinë ku në atë kohë banonte i pandehuri<sup>5</sup>.
42. Të dy dëshmitarët ,M. T. dhe A. K. morën pjesë në kërkim në cilësinë e tyre si policë dhe konfirmuan gjetjet në raport.

---

<sup>4</sup> Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor kryesor i 26 shkurtit 2018

<sup>5</sup> Dëshmitarët M. T. dhe A. K., Procesverbali i shqyrtimit kryesor i datës 13 shtator 2016, i lexuar për procesverbal në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 22 maj 2017

43. Dëshmitari Ekspert i forenzikës, S. D. -Drejtor i Departamentit të Kimisë dhe Biologjisë në Agjencinë Kosovare për Forenzikë të Kosovës në Prishtinë konfirmoi se me këtë rast u gjetën një sasi prej 7, 87 gram marihuanë dhe dy peshore me gjurmë të narkotikëve.
44. Pretendimet ndërlidhëse të prokurorisë se më 22 dhjetor 2010 i pandehuri kishte në zotërim një sasi prej 2 kilogram heroinë, të cilën ai kishte ndërmend t'i shiste D. dhe P. në këmbim të shumës 28.000 euro.
45. Që nga fillimi, trupi gjykues vëren se nuk ka prova të forta për të vërtetuar se i pandehuri ishte në posedim të ndonjë sasive të drogës në ditën kritike ose ishte në ndonjë mënyrë të përfshirë në transaksionin e sasisë së drogës të specifikuar në Aktakuzë.
46. Faktet e vetme që mund të vërtetohen janë se, me të vërtetë, i pandehuri atë ditë ka vozitur për te C. R. dhe se ndërsa ishte aty u qëllua.
47. Pjesa tjetër e teorisë së paraqitur nga Prokuroria nuk mbështetet nga provat e paraqitura në këtë proces dhe prandaj konsiderohet si e pabazuar.
48. Edhe nëse i pandehuri nuk ka ofruar ndonjë motiv të besueshëm se pse është sulmuar dhe rrethanat e këtij incidenti janë vërtet të paqarta, vetëm kjo si e tillë nuk mund të shërbejë për të vërtetuar akuzat e prokurorisë, aq më tepër duke qenë se barra e provës i takon kësaj të fundit.
49. Duhet të theksohet se gjatë kontrollit, një sasi e caktuar e marihuanës u identifikuan në vendbanimin e të pandehurit. Duke u rezervuar në atë se i pandehuri nuk ishte i vetmi banor i shtëpisë, kjo mund të tregojë se i pandehuri mund të përfshihet në përdorimin ose trajtimin e substancave të tilla. Megjithatë, sasia e narkotikëve të gjetur në kërkim nuk është aq e rëndësishme sa të sugjerojë një model të ngjashëm me atë të përshkruar

në Aktakuzë. Më e rëndësishmja, kjo sasi e marihuanës nuk përfshihet në objektin e Aktakuzës, siç tregohet nga Prokuroria.<sup>6</sup>

50. Vetë prania e çfarëdo droge në automjetin e të pandehurit ose në zonën ku automjeti i tij ishte i ndaluar në kohën e incidentit në fakt nuk është vërtetuar. Asnjë lidhje nuk është krijuar mes të pandehurit dhe narkotikëve të sekuestruar nga policia tujtje në Serbi.
51. Dëshmia e R. D. nuk shërben për të hedhur dritë mbi atë që ndodhi më 22 dhjetor 2010, pasi dëshmitari e përdori privilegjin e tij ligjor për të mos pranuar t'u përgjigjet pyetjeve.
52. Prokuroria nuk ia ka dalë të sigurojë dëshmi të mjaftueshme për të provuar lidhjen dhe përfshirjen e të pandehurit me këtë dërgesë të drogës.
53. Për më tepër, nuk ka prova konkrete apo të qarta se i pandehuri dhe individët e tjerë kishin ndonjë lloj bashkëpunimi në lidhje me drogën.
54. Trupi Gjykses, bazuar në provat në dispozicion për rastin në fjalë, nuk mund të nxjerrë ndonjë përfundim të caktuar lidhur me ekzistencën ose natyrën e mundshme të bashkëpunimit ndërmjet të pandehurit dhe katër individëve të tjerë.
55. Përmbajtja e përgjimeve nuk është bindëse. Derisa ekziston mundësia që bisedat janë të shifruara dhe synojnë të fshehin disa veprimtari të paligjshme, ky përfundim nuk mund të nxirret vetëm në bazë të përmbajtjes së tyre. Përveç kësaj, nuk ka ndonjë provë tjetër vërtetuese në mbështetje të kësaj teorie. Qëllimi i komunikimit mbetet i paqartë. Prandaj, dëshmia me anë të përgjimit është jo bindëse përkitazi me përfshirjen e të Pandehurit dhe ndërveprimin e tij me të tjerët në lidhje me dërgesën e narkotikëve më 22 dhjetor 2010.

---

<sup>6</sup> Procesverbali i shqyrtimit kryesor gjyqësor i datës 1 shtator 2016 .

56. Përsëri, provat e mbështetura nga Prokuroria për të dëshmuar bashkëpunimin e tyre në rastin më të mirë janë prova rrethore dhe për këtë arsye janë të pamjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e organizatës kriminale të supozuar.

### **Gjetjet ligjore**

57. Sipas nenit 8 të KPK-së vepra penale duhet të kryhet me veprim apo mosveprim.

58. Neni 20 i të njëjtit kod përcakton se : "personi nuk është penalisht përgjegjës nëse nuk ka lidhje shkakore ndërmjet veprimit dhe pasojave".

59. Prezumimi i pafajësisë " ia vë prokurorisë barrën e vërtetimit të akuzës, garanton që asnjë faj nuk mund të prezumohet derisa akuzat të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm [dhe] siguron që i akuzuari të ketë dobinë e dyshimit".

60. Në bazë të këtij parimi, barra e provës e inkorporuar në detyrimin e Prokurorisë për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit përtej dyshimit të arsyeshëm nënkupton që duhet të vërtetohet dhe të provohet se nuk ka alternativa të tjera të arsyeshme nga ajo të demonstruar Prokurori. Siç shpjegohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në rastin B., M. dhe J. kundër Spanjës, në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ): "Paragrafi 2 [i Nenit 6] mishëron parimin e prezumimit të pafajësisë. Ajo

kërkon, ndër të tjera, që gjatë kryerjes së detyrave të tyre, anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojnë me idenë e paragjykuar që i akuzuari ka kryer veprën penale; barra e provës i bie prokurorisë dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të Akuzuarit”.<sup>7</sup> "Prandaj, ky parim është thelbësor për të drejtën që të konsiderohet i pafajshëm deri sa të provohet fajësia sipas ligjit. Më pas, bazuar në parimin e in *dubio pro reo*, gjykata, kur vlerëson faktet dhe provat, në rast dyshimi duhet të vendosë në favor të te Akuzuarit..

61. Tribunali i Jugosllavisë sqaroi se ky standard "*kërkon që gjetësi i fakteve të jetë i bindur se nuk ka ndonjë tjetër shpjegim të arsyeshëm të provave përveç fajit të të akuzuarit*".<sup>8</sup>
62. Ndërsa konkluzion i përfshirjes së të pandehurit në një aktivitet të caktuar që lidhet me narkotikët mund të nxirret nga fakti se në këtë vendbanim është gjetur një sasi e vogël e marijuanës dhe një peshore, nga këndvështrimi i trupit gjykues , nuk ka elementë të tjerë për të vërtetuar pretendimet në Aktakuzë. Medoemos kjo ndjek, duke pasur parasysh barrën e provës, që nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga ana e Prokurorisë se i pandehuri ishte në ndonjë mënyrë i përfshirë në shkëmbimin e sasisë së 2 kg heroinë më 22 dhjetor 2010 ose se ai ishte pjesë e një organizate kriminale të ngritur për këtë qëllim. Dyshimi dhe prania e zgjidhjeve alternative të mundshme dhe të besueshme duhet interpretuar në favor të të akuzuarit, bazuar në parimin e *in dubio pro reo*.

---

<sup>7</sup> A 146 (1989); 11 EHRR 360 para 77 PC;

<sup>8</sup> *Prokurori kundër M. M.* (IT-95-11-A), Dhomat e Apelit të ICTY (8 tetor 2008) §§55, 61.



63. Në përmbledhje të kësaj, Trupi Gjykses nuk mundi të vërtetojë përtej dyshimit të arsyeshëm faktet që dolën nga akuzat kundër të te akuzuarve.
64. Në të drejtën penale *actus reus* përbëhet nga të gjitha elementet e krimit tjetër nga gjendja e mendjes së të pandehurit.
65. *Actus reus* i veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri nën dy pikat e Aktakuzës nuk u arrit të vërtetohej. Pra sipas standardeve ligjore nuk është plotësuar *Actus reus* dhe i pandehuri nuk mund të konsiderohet të jetë penalisht përgjegjës.
66. Pasi që nuk janë gjetur elementet objektive të veprave penale sipas ligjit në fuqi në momentin e kryerjes së veprave, është e panevojshme të analizohet elementi subjektiv apo *mens rea*.
67. Nga sa u tha më lartë, akuzat kundër të pandehurit nuk janë vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe ai shpallet i pafajshëm dhe lirohet nga akuzat (neni 364 (1.3) i KPP-së).

**Kryetare e Trupit Gjykses**

**Roxana Comsa**

**Anëtarë të Trupit Gjykses**

**Franciska Fiser**

**Arnout Louter**

**Procesmbajtës**

**Dukagjin Kerveshi**

MJETI JURIDIK: Në përputhje me nenet 380 (1) dhe 381 (1) të KPP-së, i pandehuri, avokati i tyre, prokurori, pala e dëmtuar ose përfaqësuesi i

*autorizuar nga ta kanë të drejtë të ushtrimit të ankesës 15 ditë nga dorëzimi i këtij aktgjykimi. Çdo ankesë duhet të dorëzohet në Gjykatën e Shkallës së Parë sipas nenit 388 (1) të KPP-së*